



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:237488

Datë: 15.08.2024

Numri i dokumentit: 06053496

AC-I-23-0359

Në ankesën e

Paditësi

H B, Podujevë.

Kundër

E paditura/Ankuesja

N.SH "FAN "Zahir Pajaziti", Podujevë (në Likuidim) e cila është e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe, Hasim Sogojeva gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjyqimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-1615 të datës 19 maj 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 15 gusht 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.**
- 2. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-14-1615 i datës 19 maj 2023 dhe Vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. PRN046-0756 i datës 19 mars 2014.**
- 3. Obligohet e paditura që në emër të pagave të pa paguara për muajin mars 2003, për muajt janar, shkurt, mars, dhjetor 2004 dhe muajt**

janar, shkurt, mars 2005, ti paguaj paditësit shumën prej 1,172.77 euro, interesin ligjor prej 10% në shumë prej 117.27 euro, si dhe shumën prej 20.00 euro për pagës të taksës gjyqësore, sipas prioriteteve të kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

4. Pjesa tjetër e kërkesës së paditësit për pagat e papaguara për muajit dhjetor 2002, janar dhe shkurt, 2003, refuzohet si e pabazuar.

5. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike:

Me 10 prill 2014, paditësi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një kërkesë/ankesë kundër Vendimit nr. PRN046-0756, të datës 19 mars 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa për të kompensimin e pagave në shumë të paspecifikuar nga NSH FAN "Zahir Pajaziti" (në likuidim).

Në ankesën e tij, paditësi pohoi se ai ka të drejtë në paga të papaguara dhe se AKP-ja nuk ia ka refuzuar këto kërkesa mirëpo e njëjta pretendon se kërkesat e tij janë parashkruar. Paditësi gjithashtu thekson se NSH-ja e ka pranuar borxhin në bazë të shkresës me emërtimin 'Listë e 11 rrogave të mbetura borxh për punëtorin H B' e datës së datës 24 mars 2006. Si përfundim paditësi i kërkon Gjykatës që të ndryshoj vendimin e kundërshtuar të AL-së dhe të aprovoj kërkesën e punëtorit të NSH-së "Zahir Pajaziti" në Podujevë, apo të njëjtin vendim ta prish dhe çështjen ta kthej në rivendosje tek AL i AKP-së. Në mbështetje të ankesës së tij paditësi ka dorëzuar dëshmitë në kopje si: vendimin e kundërshtuar të AL-së, Njoftimin për shkëputjen e marrëdhënies së punës datë 24 mars 2006, lëshuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM), një shkresë që Sindikata e Pavarur Metalistëve iu është drejtuar AKM-së për adresimin e 11 pagave të papaguara, datë 26 shkurt 2007 dhe letërnjoftimin.

Me 29 janar 2020, e paditura AKP parashtroi mbrojtje në të cilën pohoi se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se ankesa e parashtruar nuk ka përmbushur

kriteret e pranueshmërisë siç parashihet nga neni 74.2 të Ligjit 06/L-086, e cila parasheh që ankesat e dorëzuara në DHPGJS, kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. E paditura pohoi se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara në ligj dhe se kërkesa i tij është parashkruara në bazë të nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034, duke theksuar se kërkesa duhet të jetë paraqitur në gjyq apo në ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tri viteve nga momenti kur NSH-ja pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa pranueshme dhe e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL. Në mbështetje të pretendimeve në këtë mbrojtje, AKP ka bashkëngjitur një kopje të vendimit mbi emërimin e anëtarëve të AL.

Me 21 shtator 2022, gjykata lëshoi urdhër për paditësin me të cilin kërkoi që të dorëzoj prova shtesë në mbështetje të pretendimeve lidhur me kompensimin për paga të papaguara për periudhën e cekur si në ankesë. Paditësi u përgjigj në urdhrin e gjykatës dhe dorëzoi: Listën e rrogave të mbetura borgj për punëtorin H B (ankuesin) nr. 63, datë 24 mars 2006 dhe ri dorëzoi shkresën e Sindikatës drejtuar AKM-së, me 26 shkurt 2007.

Me 19 maj 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, ka marrë Aktgjykimin C-IV-14-1615, me të cilin e ka aprovuar ankesën si të bazuar, e ka ndryshuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. PRN046-0756 të datës 19 mars 2014 dhe e ka obliguar të paditurën AKP-në që paditësit në emër të kompensimit për paga të papaguara për periudhën dhjetor 2002 – mars 2005, t'i paguaj shumën prej 1,705.13 €, si dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t'i paguaj shumën prej 170.51 €, të cilat shuma do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit. Po ashtu e ka obliguar AKP, që të paguaj paditësit taksën gjyqësore në shumë prej 20.00 €.

Shkalla e I-rë ka arsyetuar se neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë. Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet

e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*). Ka arsyetuar se neni 14.1 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës) parasheh që: *“Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës”*. Neni 55.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit) parasheh që: *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”* .

Shkalla e I-rë kishte vlerësuar se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se paditësi ishte një punëtor i NSH “FAN – Zahir Pajaziti”. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja se a ka ofruar shërbime pune ankuesi dhe a i ka mbetur NSH borgj pagat për periudhën dhjetor 2002 - mars 2003, janar 2004 – mars 2004 dhe dhjetor 2004 – mars 2005. E paditura e kundërshton kërkesën e paditësit duke pretenduar se kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të papaguara është parashkruar, ndërsa paditësi pretendon se ka qenë në listën e pagave deri në privatizimin e NSH.

Shkalla e I-rë ka konstatuar se nga, njoftimi për përfundimin e punësimit, i datës 24 mars 2006, i dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se paditësi ishte në marrëdhënie pune në NSH “FAN – Zahir Pajaziti” deri me 24 mars 2006, kohë edhe kur shumica e aseteve të NSH-së janë shitur dhe si pasojë marrëdhënia e punës së ankuesit ka pushuar.

Nga lista e pagave e hartuar dhe nënshkruar nga NSH “FAN – Zahir Pajaziti” dhe e konfirmuar nga drejtori i NSH-së, vërtetohet fakti se NSH-ja i kishte mbetur borgj ankuesit disa paga për disa muaj për periudhën dhjetor 2002 – mars 2005 në shumë totale prej 1,705.13 €, shumë kjo e kërkuar nga paditësi në procedurën e likuidimit dhe objekt shqyrtimi në këtë procedurë.

Shkalla e I-rë i ka pranuar si prova relevante dhe të bazuara, Njoftimin për përfundimin e punësimit, lëshuar me 24 mars 2006 nga AKM dhe Listën e pagave për ankuesin (nr. 63, datë 24 mars 2006), për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime pune për NSH për periudhën e lartcekur dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borgj pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se NSH nuk i ka mbetur

borgj pagat, ashtu siç ka pretenduar ankuesi. Meqenëse e paditura nuk e ka kontestuar periudhën kohore të pagave të papaguara dhe as lartësinë apo shumën totale të pagave të papaguara të kërkuara nga ankuesi, si dhe nuk ka ofruar asnjë provë që do mund të rrëzonin pretendimet e ankuesit, gjykata e aprovon plotësisht kërkesën e tij.

Lidhur me pretendimi i të paditurës se kërkesa e paditësit është parashkruar, shkalla e I-rë kishte konstatuar se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kësioj pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore.

Shkalla e I -rë e ka aprovuar shumën në lartësi prej 170.51 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Me 16 qershor 2023, e paditura e dorëzon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-14-1615 të datës 19 maj 2023, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave të së drejtës materiale, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e saj si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN046-0756 i datës 19 mars 2014. Për më tepër në ankesë e paditura ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktit të çështjes. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur që Gjykata i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra përkatësisht dy afate të ndryshme dhe atë afatin për parashtrimin e kërkesave që është afat procedural për të dorëzuar dëshminë e kërkesës në procedurën e likuidimit dhe afatin ligjor për të kërkuar mbrojtjen e të drejtës së pretenduar-afatin e parashkrimit i cili në këtë rast është 3 vjet në bazë të nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Këto dy afate janë të ndara dhe të dallueshme të cilat duhet të përmbushen nga çdo pretendues në mënyrë që të pranohet kërkesa. Tutje AKP-ja ka pretenduar se kërkesa për paga është parashkruar, në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Më 16 korrik 2024, Gjykata ka lëshuar urdhër i cili mund të parashtrojë përgjigje ndaj ankesës së AKP-së, i njëjti e ka pranuar urdhrin me 19 korrik 2024, por nuk ka parashtruar përgjigje deri në marrjen e këtij Aktgjykimi.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë i DHPGJS nuk është plotësisht i saktë i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj si i tillë duhet të ndryshohet.

Kolegji i Apelit vëren se, kërkesa e paditësit për pagat e papaguara ishte refuzuara si e pavlefshëm nga AL, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Paditësi në ankesën e dorëzuar në DHPGJS me datë 10 prill 2014, e konteston vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN046-0756, të datës 19 mars 2014, dhe vazhdon ti kërkojë 11 paga të papaguara për periudhat dhjetor 2002 e deri në mars 2005, duke pohuar se ai ka punuar deri në ditën e privatizimit të NSH-së me 24 mars 2006, kur edhe i është lëshuar njoftimi për përfundimin e punësimit.

Kolegji i Apelit vëren që Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit, e ka aprovuar në tersi ankesën e paditësit si bazuar dhe e ka ndryshuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN046-0756 të datës 19 mars 2014, e ka obliguar Autoritetin e Likuidimit -AKP-në që në emër të kompensimit për pagat e papaguara për periudhën kohore dhjetor 2002-mars 2005, t'ia paguaj paditësit shumën prej 1,705.13 euro, në emër të interesit ligjor prej 10% ti paguaj shumën prej 170.51 euro, si dhe për taksë gjyqësore prej 20.00 euro.

E paditura në procedurën ankimore edhe me tutje e mbetet pranë qëndrimit të saj të paraqitur gjatë mbrojtjes në Shkallë të I-rë, se kërkesa e paditësit për pagat të papaguara është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Ajo rithekson se paditësi ka dështuar të paraqet prova në gjykatë se ai i ka kërkuar pagat e papaguara brenda 3 viteve, nga koha kur NSH nuk i ka paguara pagat paditësit.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në shkallën e I-rë bashkë me ankesën e tij ka dorëzuar: vendimin e kundërshtuar të AL-së, Njoftimin për shkëputjen e marrëdhënies së punës datë 24 mars 2006, lëshuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM), një shkresë që Sindikata e Pavarur Metalistëve iu është drejtuar AKM-së për adresimin e 11 pagave të papaguara, datë 26 shkurt 2007 dhe letërnjoftimin si dhe dhe listën e pagave të mbetura borxh e përpiluar nga NSH-ja e të nënshkruara nga zyrtaret përgjegjës të NSH-së, dt. 24 mars 2006.

Kolegji i Apelit konsideron që Njoftimi i ish AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës që është prezantuar si provë në gjykatë, e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës, për pagat e papaguara nga muaji mars 2003 e deri në mars 2005.

Ky njoftim në përmbajtjen e tij përcakton se "shumat-pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura".

Andaj duke u bazuar në këtë Njoftim të AKM-së, pas fillimit të procedurave të likuidimit, paditësi e ka paraqitur kërkesën e tij për paga tek Autoriteti i Likuidimit siç ishte njoftuar me njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies të punës me datë 24 mars 2006.

Edhe Kolegji i Apelit vlerëson se paditësi i takon e drejta në kompensimin e pagave të pa paguara duke u bazuar në listën e nënshkruar nga menagjmenti i NSH-së, sipas së cilës paditësit i janë mbetur borxh paga e muajit mars 2003, pagat e muajit janar, shkurt, mars, dhjetor 2004, dhe pagat për përudhen janar- shkurt, mars 2005, dhe duhet ti paguaj e paditura paditësit shumë prej 1,172.77 euro. Bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP- e padatuara paditësit duhet ti paguaj edhe interesin ligjor prej 10% në shumë prej 117.27 euro, që do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Kolegji vlerëson se pagat e paditësit për muajin dhjetor të vitit 2002 dhe për muajt janar dhe shkurt të vitit 2003, janë parashkruar. Paditësi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të vërtetuar faktin se ai ka paraqitur kërkesë për pagesën këtyre tri pagave të papaguara, para njoftimit të lëshuar nga AKM për ndërprerje të marrëdhënies së punës, andaj kërkesa për këto paga duhet të refuzohet si e pabazuar.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit konstaton se ankesa e të paditurës duhet aprovuar pjesërisht si e bazuar, ndërsa duhet ndryshuar Aktgjykimin e ankimuar dhe padia e paditësit është pjesërisht si e bazuar, vetëm sa i përket pjesës së kërkesës për paga të pa paguar për periudhën mars 2003 e deri në mars 2005.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë taksën gjyqësore për procedurën ankimore e ka paguar me datë 12 korrik 2023 në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 15 gusht 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
